

*Dr. Zeqirja Idrizi*

## ROLI I MEHMET PASHË DERALLËS NË SHPALLJEN E PAVARËSISË

Jeta dhe veprimtaria e Mehmet pashë Derallës është me interes për hulumtues të fushave të ndryshme. Natyrisht, për këtë personalitet historik më shumë janë interesuar ata që e kishin dhe e kanë objektiv kërkimi të kaluarën e popullit shqiptar. Interesimi për jetën dhe veprimtarinë e kësaj figure me rëndësi sa vjen e shtohet më shumë tek ata që në kishin pasur kontakte me bashkëkohësit dhe me bashkëluftëtarët e tij, veçanërisht me ata të Pollogut dhe të Kosovës. Në biseda me këta njerëz venerohen vlerësime të llojlloshme për këtë figurë historike. Ka vlerësime të cilat Mehmet pashë Derallën të thuash e shejtërojnë, por ka edhe të tilla që e shpallin renegat osman, serb e malazez.

Vlerësimet e fundit i gjejmë veçanërisht në viset e afërta me Pollogun, ndërsa zbehen krahas largimit nga vendlindja dhe ana e tij. Kjo më së miri provohet nga kënga e thurur për Mehmet pashë Derallën nga labët:

*O Mehmet Pashë Deralla,*

.....

*Të këndon Labëria,*

*Siç këndonte për Gjon Lekën,*

*Të këndon historia,*

*Kur për nënën të japin jetën.*

Përveç veçorisë së shqiptatëve që të mos i çmojnë sa duhet të afërmit, kjo dukuri ka të ngjarë se është stimuluar fshehurazi edhe nga propaganda e pushtuesve.

Propaganda denigruese kundër M. P. Derallës e bashkëmendimtarëve të tij, kuptohet, duhej rrënjosur së pari tek të afërmit dhe anasit të tij e më

pastaj të merte dhenë e të kurorëzohej me sukses. Denigrimi i M. P. Derallës në radhë të parë nga ana e armiqve të tij shprehej edhe tek atdhetarët e tjerë shqiptarë, para së gjithash tek ata me të cilët bashkëpunonte ky personalitet i shquar. Në këtë mënyrë tërthorazi, por në mënyrë mjaft të suksesshme, përgojohej e njollosej e tërë Lëvizja Kombëtare Shqiptare ngaqë veprimtaria dhe gjallërimi i saj pengonte dhe pengon çdo pushtues të shqiptarëve.

Pushtuesit e shqiptarëve nuk denigruan vetëm shembëlltyrën e Mehmet pashë Derallës, por kështu vepruan edhe me patriotët të tjerë kombëtarë dhe për sendërtimin e qëllimeve të tyre nuk kursyen as mund as mjete financiare të shumta. Siç është e ditur, ata kështu vepruan edhe me Hasan Prishtinën, Idriz Seferin, Hasan Hysen Budakovën, Isa Boletinin e të tjerë. Edhe bashkëpunimi i tyre i sinqertë me popujt fqinj dhe me forcat e tjera të kohës u shfrytëzuan mjaft për përfoljen dhe përdhosjen e veprimtarisë së tyre kombëtare.

Përfolja dhe përdhosja e veprimtarisë kombëtare të Mehmet pashë Derallës me shokë nga ana e pushtuesve kishte arsye të forta. Ata ishin njerëz me autoritet dhe koka të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ndikimi i tyre në lidhjen dhe ndërlidhjen e Lëvizjes për Çlirimin Kombëtar ishte pothuajse i pazëvendësueshëm. Asgjësimi i veprimtarisë së tyre ndikonte pothuajse drejtpërdrejt në zhvillimin dhe përkrahjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Përgojimi dhe asgjësimi i këtij personaliteti do të ndikonte ndjeshëm në veprimtarinë e Lëvizjes Kombëtare. Po të sendërtohej ky synim do të shkëputeshin hallkat kryesore të lidhjes së kësaj lëvizjeje në antë të ndryshme në Pollog, Kosovë e më gjerë dhe ajo nuk do të kishte, bile së paku, karakterin gjithëkombëtar, që do të ndikonte domosdo në suksesin e saj përfundimtar.

Pa bashkëpunimin e atdhetarve të Pollogut me ata të Dibrës, Karadakut, Lumës dhe të Kosovës pothuaj se nuk mund të merrej me mend bashkëpunimi i kësaj lëvizjeje me Shkupin, sikur as bashkëpunimi me atdhetarët e anës së Gjilanit dhe të Karadakut. Për rëndësinë e këtij bashkëpunimi ishte i vetëdijshëm edhe Mehmet pashë Deralla, prandaj i kushtoi rëndësi të madhe kësaj çështjeje dhe gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij u gjend në vise të ndryshme shqiptare.

Rolit dhe ndikimit të Mehmet pashë Derallës në Pollog, por edhe më gjerë, deri më tash nuk i kanë kushtuar fare kujdes historianët që janë marrë me Rilindjen dhe me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në radhën e martirëve të kombit tonë, të cilët për idealet kombëtare edhe jetën dhe familjet e tyre i shkrinë është Mehmet pashë Deralla.

Mehmeti u lind në Gradec të Tetovës në vitin 1843, në familjen e Hasan pashë Derallës, njëri ndër patriotët më të njohur të trevës së Teto-

vës dhe gjithë Vilajetit të Kosovës. Kjo familje ishte e njohur për traditat e saja ushtarake. Gjatë viteve 1843-1845, gradecarët morën pjesë aktive në kryengritjen e Dervish Carës, për shpërthimin e së cilës ishte marrë si shkas largimi i Hasan pashë Derallës nga pashallëku i Qustendilit, i Hivzi pashë Derallës nga ai i Shkupit dhe i Abdurahman Pashës (Derallës Z .I) nga ai i Tetovës.<sup>1</sup>

Siç shihet, Mehmet pashë Deralla u lind në valën e luftës, pra atëherë kur shqiptarët e këtyre anëve dhe Derallët i kishin drejtuar armët kundër Perandorisë Osmane, konkretisht kundër Reformave të Tanzimatit. Në gjun e kësaj familjeje u rrit dhe mori një edukatë të mbrujtur me ndjenja të thella dashurie për atdheun dhe për tokën e të parëve. Mehmeti mësimet e para i mori në vendlindje, shkollën e mesme e kreu në Shkup.<sup>2</sup> Meqë prirëj nga dëshira për dije dhe nga kërkesa e të atit për t'u bërë ushtarak, familja e dërgoi në Stamboll, të njohur për shkolla ushtarake. Atje kreu Shkollën e Lartë Ushtarake (Akademia e Parë Ushtarake) dhe u diplomua oficer. Meqenëse studimet i përfundoi me rezultate të shkëlqyeshme, shërbeu për disa kohë në një rregjiment këmbësorie në Anadoll dhe pasi u vlerësua "i zellshëm, me perspektivë" iu dha e drejta të studiointe në Akademinë e Dytë ose Shkollën e Lartë të Shtatmadhorisë,<sup>3</sup> që e përfundoi po me rezultate të larta.

Menjëherë pas kësaj kohe nisi karriera e ushtarakut, duke ushtruar detyra të ndryshme dhe të shumta në radhët e ushtrisë osmane. Mehmeti së pari u emërua komandant xhandarmërie në Bagdat të Irakut dhe në Halep të Sirisë. Kështu rodhi tërë rruga e rritjes dhe e formimit të tij si ushtarak. Pikërisht në këtë rrugë, krahas ngritjes profesionale, afirmohet edhe si atdhetar i zjarrtë që e do atdheun me zemër, por edhe me vepra. Në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte në detyrën e komandantit të xhandarmërisë në qarkun e Prizrenit, ku u njoh me Haxhi Zekën.<sup>4</sup>

Për meritat dhe arritjet në detyrat e shumta që iu ngarkuan në një shtet me një ushtri të njohur për traditat dhe kërkesat e larta ishte nga të paktët që qysh në moshë të re 35-vjeçare në vitin 1878 fitoi gradën e

<sup>1</sup> Aleksandar Matkovski, *Kryengritja e Dervish Carës*, Shkup 1985, f. 44, Tetovo i Tetovsko niz istorijata, Tetovo, 1982, f. 39; Dr. Shukri Rrahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 1986, f. 13.

<sup>2</sup> Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën pavarësinë kombëtare*, Tiranë, 1997, f. 51, Gazeta "Flaka" 26 maj 1997.

<sup>3</sup> Dr. Gjergj. P. Titani-Prof. Dr. Proletar Hasani, *Personalitete Ushtarake në vitet 1912, dhjetor 1997*, Tiranë, 1997, f. 14.

<sup>4</sup> Bardhosh Gaçe, vep. e cit. f. 52; Prof. Dr. Kristaq Prifti, libri *Shqiptarët e Maqedonisë*, 1994, f. 243, gazeta "Flaka" 23 maj 1997.

gjeneralit.<sup>5</sup> Mirëpo, mbi të gjitha ai ishte një gjeneral që ushqente ndjenjat dhe dashurinë për popullin dhe atdheun e tij. Në librin “Shqiptarët në Perandorinë Osmane”, ndër të tjera, shkruhet: “Mehmet Pasha ishte atdhetar i flaktë, i zgjuar, nuk duronte dot intrigat e huaja. Nga ky shkak nuk u pajtua me Qeverinë e Stambollit”.<sup>6</sup>

Gjatë kohës që ishte komandant i xhandarmërisë për Vilajetin e Kosovës, përpos lidhjeve me ushtarakë dhe atdhetarë të shquar e të njohur si B. Curri, R. Zaskoci, I. Seferi, etj. përkrahu dhe ndihmoi edhe shumë veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare shqiptare, zbuloi provokatorë, realizoi takime të fshehta e të suksesshme me elementë atdhetarë në dobi të çlirimit të Shqipërisë.

Tabloja e formimit dhe e veprimtarisë do të plotësohej gjatë jetës së tij dinamike. Ajo do të fitonte dimensione të reja gjatë veprimtarisë në një prej organizimeve më të famshme të historisë së popullit shqiptar, në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, idetë e sëcilës i përqafoi, i përkrahu dhe i mbështeti me veprime konkrete. Jo vetëm kaq, por ai luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e forcave dhe të veprimtarisë luftarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit gjatë tri vjetëve të jetës së saj. Duke njohur kulturën dhe përvojën e tij shumë të pasur luftarake, drejtuesit e Lidhjes e zgjodhën komandant të forcave ushtarake të Lidhjes në viset shqiptare të Maqedonisë, një zonë me rëndësi të veçantë strategjike.<sup>7</sup> Po ashtu, në kreun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878 radhitej edhe babai i tij Hasan pashë Deralla, njëra ndër figurat më të shquara.<sup>8</sup> Këtë e vërteton edhe konsulli Lippih, i cili, pos Hasan Derallës si pjesëmarrës të Lidhjes numëronte Ali beg Gucinë, Iljas pashë Dibrën, Abdullah pashë Drenin dhe Ahmet Koronicën, gjykatësin nga Gjakova. Delegatët nga Tetova ishin: Esad pashë Tetova, Mehmet Tetova (Deralla Z. I.), Sheh Mustafa Tetova, Rexhep pashë Deralla, Hasan Musharanuredin (Deralla Z. I.), Haxhi Sadiku, Mehmet Efendiu, Abdyl Reufi, Riza Fuat.<sup>9</sup> Në “Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (1878-1912) vërejmë se në memorandumet, vendimet, protestat dhe apelet e asaj periudhe janë të pranishme edhe mendimet dhe përgjegjësia e Hasan Derallës. Kështu, në statutin “Kararnamë” dhe “Urdhëresa” (“Talimat”) të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për organizimin politik e ushtarak nga qendra në bazë, ndër

<sup>5</sup> Si në fusnotën e tretë. f. 20.

<sup>6</sup> N. Alpan, N. Kaçi: “Shqiptarët në Perandorinë Osmane”, Tiranë, 1997, f. 104.

<sup>7</sup> Prof. Dr. Skender Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1885*. Prizren 1998, f. 128.

<sup>8</sup> Gjergj Fishta, *Lahuta e Malësisë*, kënga e nëntë.

<sup>9</sup> Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj 1878-1881*, Tiranë 1939, f.

392, Ligor Mile, *Dokumente arkivash franceze 1 1876-1879*, Tiranë, 1978, f. 178, dokumenti 128.

54 përfaqësues, sipas radhës i pesti vjen komandant Mehmeti (i biri i Hasan Derallës Z. I), ndërsa i gjashti komandant Hasan Deralla.<sup>10</sup> Pëlqimi, miratimi, nënshkrimi dhe vulosja e këtyre dokumenteve programatike përmbajnë ndihmesat dhe angazhimin edhe të tetovarëve ndër të cilët më i zellshëm rezultoi Hasan Deralla me të birin Mehmetin. Ky qëndrim, kjo edukatë e trashëgimi e vyer jo thjesht në planin pasuror, por mbi të gjitha në këndvështrimin atdhetar, human e kombëtar në mënyrë të natyrshme do t'u mbillej e rrënjosej pasardhësve të panumërt të Derallëve, së pari Mehmetit e mandej nipit Halim Beg Derallës, sepse kështu përvihohej e masivizohej nderi dhe detyra e Derallëve. Në vitet 1878-1881, sipas detyrave të ngarkuara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, bashkëpunoi me Sulejman Vokshin. Lidhja e Prizrenit e ngarkoi me detyrën e komandantit të Forcave Luftarake në Tetovë-Gostivar.<sup>11</sup> Kudo që i jepej mundësia, sidomos në malësinë e Sharrit, në Tetovë e në Prizren, kudo që merrte pjesë- në besëlidhje, në pajtim gjaqesh dhe në regjistrimin e vullnetarëve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Mehmet Deralla thoshte: "Jemi shqiptarë, s'e duam të huajin në vatrën tonë; vetëm lufta me mend e me pushkë ka me na qitë në dritë."<sup>12</sup> Kësisoj, nga Këshilli Kryesor (i Përgjithshëm) i Lidhjes dhe udhëheqësi ushtarak i Forcave të Armatosura, Sulejman Vokshi, gjeneral Deralla vlerësohej në mënyrë të veçantë. Për të dhe për Lëvizjen ai ishte njëri nga ushtarakët e vetëm të profilizuar, me kulturë të gjerë akademike dhe me përvojë të bollshme.<sup>13</sup> Nisur nga këto dhunti moralo-atdhetare aq të kërkuara në çaste historike për fatet e një kombi, atij iu ofrua vendi i këshilltarit dhe luajti rolin e një reformatori në Shtabin e S.Vokshit për organizimin dhe përgatitjen ushtarake të Ushtrisë Kombëtare, të operacioneve dhe betejave, që u realizuan gjatë tri viteve (1878-1881).

Është diçka e veçantë dhe shumë i admiruar fakti që në të njëjtin organizëm politik e ushtarak, si Lidhja e Prizrenit, merrnin pjesë e jepnin ndihmesë të vyer dy figura të ngritura dhe dy shtylla nga një derë, i ati Hasan Deralla, më tepër si politikan, dhe i biri Mehmeti më shumë si ushtarak.<sup>14</sup>

<sup>10</sup> Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë, 1978, f. 47, Kristo Frashëri, LSHP 1878-1881, Tiranë 1989, f. 191, Gjurmime Albanologjike, Seria e shkenca-ve historike VIII-1978, Prishtinë, 1979, f. 202.

<sup>11</sup> B. Gaçe, vep. e cit. f. 52.

<sup>12</sup> Gazeta "Flaka" 23 maj 1997.

<sup>13</sup> Dr. Vangjel Kasapi, *Mehmet Deralla*, Tiranë 1995, f. 30, gazeta "Rilindja" 25 nëntor 1992.

<sup>14</sup> Aktet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912. Tiranë 1978, f. 47.

Me një hov rinor dhe atdhetar, me kompetencë profesionale dhe përkushtim të patundur, Mehmet Deralla iu përvesh luftës për çlirimin e vendit nga robëria shekullore osmane, për mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut dhe për formimin e shtetit kombëtar. Pas dështimit të Lidhjes së Prizrenit, deri në fillim të shekullit të ri strehohet në Tetovë, ku vehet nën një kontroll të rreptë, por edhe këtu gjenerali ngre bazat dhe krijon lidhjet e tij me shumë atdhetarë dhe njerëz të rendomtë të qytetit e të fshatrave, me persona me ndikim dhe me bërthamat organizative politike, kulturore e ushtarake, të cilat mundën t'i shpëtojnë represionit pas shpërbërjes së rrjetit të Lidhjes së Prizrenit. Punonte e sakrifikonte sa mundej për të mbajtur gjallë frymën e besimit dhe të gatishmërisë për ditët dhe vitet e mëpastajme. Nga 1881 deri më 1890 Mehmeti ndikoi në mbarëvajtjen e disa tubimeve të vogla që u zhvilluan në krahinë. Kudo dha mendime të matura e të vyera për situatat që zhvilloheshin dhe për të mos rënë në grackën e armikut. Përmes veprimeve pa bujë, në çdo fshat, në çdo shtëpi e kokë më kokë me bashkatdhetarë mbante të ndezur flakën e vëllazërimit e të luftës për liri.

Kuvendi i Pejës (23-29 janar 1899), një organizatë politiko-ushtarake mbarëshqiptare, i dyti për nga rëndësia pas atij të Prizrenit, përvijoi po atë rrugë, i shtroi po ato objektiva. Deralla spikat ndër 450 delegatët, u bë njëri ndër prijësit popullorë. Krahas Haxhi Zekës e atdhetarëve të tjerë ishte njëri ndër themeluesit e kësaj Lidhjeje dhe ndër hartuesit e “programit” të saj prej 11 pikash.<sup>15</sup>

Haxhi Zeka dhe Lidhja e Pejës Mehmet Derallën e ngarkuan me organizimin e tubimeve në Prizren, Kërçovë, Ohër, Dibër e Gostivar.<sup>16</sup> Për punën dhe aktivitetin e tij Mehmeti çmohej si burrë, mendimtar, organizator e drejtues i mençur përkrah Haxhi Zekës. Mehmeti u bë bashkautor i Lidhjes së Pejës, i “Besa-besës”, i Rezolutës 11-pikëshe, i “aktit të besës” prej 12 nenesh dhe apelit “Rruga e shpëtimit është në besa-besën”. Qëndresa e armatosur e popullit të kësaj treve sërish u ndërpre përkohësisht. Lidhja e Pejës pësoi të njëjtin fat : ajo u shtyp pa i përmbushur qëllimet dhe objektivat e saj. Atëherë Mehmet Deralla ndërroi taktikë. U vu në krye të aksioneve të veçuara e të grupeve të vogla vullnetare, duke iu kundërvënë që në embrion synimeve dhe veprimeve të monarkive ballkanike (Serbisë, Bullgarisë e Greqisë) në hapësirën shqiptare. Nën lëshimet e heshtura të Turqisë, nga dita në ditë po shtoheshin

<sup>15</sup> Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Pejës, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, 1896-1900*, Tiranë, 1984. f. 231; Reshat Nexhipi, *Shtypja dhe rezistenca shqiptare nëpër shekuj*, Manastir, 1996 f. 267; Bardhosh Gaçe, vep. e cit. f. 52; Dr. Tahir Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1900-1903*, f. 17.

<sup>16</sup> Po aty.

veprimet e shovinistëve, veçmas mbi dy vilajetet lindore shqiptare- Kosovës dhe Manastirit.<sup>17</sup>

Mbi krerët e Lëvizjes Shqiptare rinisi përndjekja dhe gjenocidi. Me dështimin e Lidhjes së Pejës Mehmet Deralla u internua në Bagdad ku qëndroi deri në vitin 1908.<sup>18</sup>

Edhe pse larg vendit ai mbante korrespondencë me të birin Halim Derallën (1870-1936) dhe Idriz Seferin. Në letrën që i shkruan të birit nga Bagdadi më 1907 shënon: “Edhe pse me zemër të plagueme ndër vise të Bagdadit rreh e fluturon ndër ato bjeshkë e kepa për me puthun ato sokola që duan me çlirue vendin prej osmanlisë”.<sup>19</sup> Lidhjet-Tetovë Bagdad nuk u ndërpre në aspiratat nuk u zbehën nga qelitë e errëta në të cilat Mehmeti u kalit edhe më tepër për betejat e ardhshme. Pollogasi 65-vjeçar, Mehmet pashë Deralla, më 5 korrik 1908 u gjend në kuvendin e Ferizajt ku nënshkroi telegramin dërguar Sulltanit, në të cilin kërkohet rivendosja e Kushtetutës së vitit 1876.<sup>20</sup> Figura e tij atdhetare u lartësua në kryengritjet antiosmane. Në vitin 1909 në Stamboll, nga senatorët dhe deputetët shqiptarë, u formua një komision shqiptar i posaçëm për rregullimin e marrëdhënieve shqiptare. Në këtë komision, që ishte një lloj qeverie shqiptare e paemruar, jozyrtare, merrte pjesë edhe gjeneral Mehmet Pasha.

Në vitet 1910-1911 e deri më 1912, së bashku me të birin e tij Halimin Mehmeti u përfshi në valën e kryengritjeve që shpërthyen në trevat shqiptare,<sup>21</sup> e të cilat shënojnë kulmin e veprimtarisë së tij luftarake. I ndodhur në qendër të vatrës së kryengritjes në Kosovë, gjenerali shqiptar, i prirë nga atdheadashuria e madhe, u fut në gjiun e kësaj kryengritjeje kombëtare, që arriti vllugun në vitin 1912. Përkrah tij qëndronin burrat e historisë sonë kombëtare Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi, Islam Spahiu, Qerim Begolli, etj.

Gjenerali me mençuri e strategji të spikatur ushtarake arriti të përcaktonte drejtimet më kryesore dhe format e luftimit që do t'i çonin forcat shqiptare drejt fitores së shpejtë e sfiduese ndaj armiqve të vendit. Kjo fitore do ta lëkundte deri në tronditje “godinën” perandorake osmane në Shqipëri dhe në tërë Ballkanin. Për rrjedhojë, në përmbyllje të fazës së

<sup>17</sup> Gjurmime albanologjike, *Seria e shkencave historike 23-1993*, Prishtinë, 1995, f. 99.

<sup>18</sup> Dr. Reshat Nexhipi, *vep. e cit. f. 267*.

<sup>19</sup> Radio Shkupi, 13 shkurt 1996.

<sup>20</sup> Skender Laurasi, *Isa Boletini*, Prishtinë 1972, f. 135; Shaban Braha, *Gjenocidi serbo-madh dhe qëndresa shqiptare (1844-1900)*, f. 73.

<sup>21</sup> Historia e Popullit Shqiptar II, Prishtinë, f. 354; Ejup Gashi, *Kontributi i shqiptarëve në organizimin e Kryengritjes së vitit 1910*, në librin “Shqiptarët e Maqedonisë”, Shkup 1994.

dytë nëpërmjet mësyemjes në tri drejtime, u arrit të merrej Shkupi, por edhe pas kësaj Porta e Lartë Osmane nguli këmbë për një autonomi mashtruese gjysmake me futjen në veprim të pushtesve serbë. Në ato çaste të vështira u vunë në zbatim idetë dhe plani ushtarak i hartuar nga gjeneral Deralla për t'ua kthyer armët edhe agresorëve serbë.<sup>22</sup> Mehmet Deralla ka merita si ushtarak se e përpunoi planin e qëndresës kundër agresionit serb. Vendin e osmanlinjve, thoshte ai, po përpiqen të na e zënë serbët e ne (nuk Z.I) do t'i lëshojmë për së gjalli.<sup>23</sup> Tetori i vitit 1912 do të shënojë në historinë e luftërave mbrojtëse të popullit tonë nivelet e tij të larta. Shkupi i drejtuar nga Mehmet pashë Deralla do të jetë një nga caqet e ushtrisë serbe e malazeze.<sup>23</sup>

Në nëntor të vitit 1912 Mehmet Deralla me Ajdin Dragën shkuan në Dibër ku u takuan me Isa Boletinin. Prej aty u nisën për në Vlorë për të marrë pjesë në Kuvendin historik të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare.<sup>24</sup> Në mbledhjen e Kuvendit të Vlorës më 30 nëntor shënohet se “si delegatë të rinj erdhën z. Mehmet pashë Deralla, Isa bej Boletini, Ajdin Draga, Dervish bej Ipeku (Peja) nga Kosova, etj.”<sup>25</sup> Sipas gazetës “Përlindja e Shqipërisë”, në mbledhjen e 3 dhjetorit 1912 kryetari i Qeverisë së Hëpërhëshme ngrihet dhe tregon kushtet që duhej t'i përmbushte Ministria për të kënaqur Evropën, nga një anë, dhe Stambollin, nga ana tjetër; duhen të jenë emra të njohur në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. Pas kësaj Z.e tij nxjerr përpara një listë si projekt. Në atë listë figurojnë këta emra: Z. Mehmet pashë Tetova, Myfit bej Gjirokastra, Azis Pasha, Vebi Efendiu, Abdi bej Toptani, Mid-had bej Frashëri.<sup>26</sup> Në mbledhjen e 4 tetorit 1912, kryetari i Qeverisë, Ismail beu, shtron përpara Kuvendit mënyrën e re të zgjedhjes së ministrave. Fuqinë që e kam unë në këtë çështje ia lë Kuvendit. Kuvendi le të zgjedhë 8 veta. Në votim fituan vetëm 5 sish: Luigj Gurakuqi me 54 vota, Myfid bej Gjirokastra 52, Mehmet pashë Tetova 42, Abdi bej Toptani 34, Mid-had bej Frashëri me 35 vota. Të tjerët shkuan në rrethin e dytë. Mehmet pashë Tetova u emërua ministër i Luftës i kësaj qeverie.<sup>27</sup>

Ky ishte një kapitull i ri i veçantë që u hap në historinë e Shqipërisë, por edhe të vetë gjeneral Derallës. Ai jetoi dhe veproi në një kohë kur në

<sup>22</sup> Personalitetet ushtarake në vitet 1912, dhjetor 1997, f. 22.

<sup>23</sup> Gazeta “Flaka”, 26 maj 1997.

<sup>24</sup> Isa Boletini dhe koha e tij, Prishtinë, 1998, f. 111.

<sup>25</sup> Gazeta “Përlindja e Shqipërisë” vit. II nr. 7, 8; datë 4-7 shkurt 1914, cit. sipas B. Gaçe.

<sup>26</sup> Po aty nr. 8, 9 datë 7-11 shkurt 1914.

<sup>27</sup> Po aty nr. 9-10, datë 11-14 shkurt 1914, Stefanaq Pollo, Në Gjurmë të Historisë 1, Tiranë 1990, f. 320.

“qiellin” e botës shqiptare shkëlqenin prijësit dhe luftëtarët e papërsëritshëm si: I. Boletini, I. Seferi, B. Curri e dhjetëra të tjerë. Ai u bë ministri i parë i Luftës i Shqipërisë, sepse çmohej nga vetë bashkëkohësit e tij si më i shkolluari ndër ta. Prandaj, kur flitej se posti i ministrit mund t’i ofrohej të famshmit Isa Boletini, vetë Isaja pat thënë me sinqeritet dhe fisnikëri: “Në Qeveri duhet të kemi njerëz me shkollë. Posti i ministrit të Luftës i takon Mehmet Derallës!”.<sup>28</sup> Flladi i lirisë e i pavarësisë i dhanë Mehmetit të thyer nga mosha energji të reja intelektuale e fizike të pabesueshme. Në këtë periudhë të vështirë, nga më të komplikuarat e më të vështirat nga çdo aspekt të jetës së Shqipërisë, gjeneralit plak, të mençur dhe plot kurajo iu desh të shpaloste tërë aftësitë profesionale dhe energjitë e veta në dy fronte. Fronti i parë ishte ai i mbrojtjes së vendit dhe i shteti të brishtë Shqiptar nga lakmitë e shovinistëve jugor dhe verior, kurse fronti i dytë ishte ai i krijimit dhe organizimit nga e para të Ushtrisë Kombëtare. Në këto kushte, ai ishte i ndihmuar edhe nga kryetari i parë i Shtabit Madhor të Ushtrisë, majori Ali Shefqeti (Shkupi)<sup>29</sup> dhe nga një plejadë personalitetesh të tjera të njohura ushtarake. Duke u bazuar në mundësitë reale politike, ekonomike, njerëzore, sociale dhe materiale të vendit dhe të kohës, duke u thelluar në realitetin shqiptar, duke njohur dhe mbështetur në ndjenjat ushtarake të gjithë popullit shqiptar, ministri i Luftës arriti të konceptonte dhe të krijonte konkretisht një ushtri të mjaftueshme dhe po aq të domosdoshme për rrethana tipike shqiptare. Në historinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare ai ka bërë një emër që lidhet ngushtë me ditëlindjen e saj 4-dhjetorin 1912.

Ky shtet i brishtë i një vendi tejet të varfër dhe që ende lakmohej, provokohej e goditej nga të gjitha anët prej fqinjve grabitçarë, kishte nevojë për mbrojtje, për rend dhe për qetësi më shumë se për çdo gjë

<sup>28</sup> Skender Laurasi, Isa Boletini, Prishtinë 1972 f. 182; Personalitetet ushtarake në vite... vep. e cit. f.23.

<sup>29</sup> Major Ali Shefqeti ka një emër që lidhet ngushtë me emrin e ministrit të Luftës të shtetit të parë shqiptar të vitit 1912 dhe me Shtabin Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, që lindi më 4 dhjetor 1912, ky ishte krahu i djathtë i ministrit të Luftës, gjeneralit Deralla. Ali Shefqeti në Vlorë arriti në prill të vitit 1913 ku menjëherë u caktua në këtë detyrë. Ali Shefqeti rridhte nga një familje e atdhetarit dhe ushtarakut të njohur Hysen Shefqeti nga Peja dhe nga një nënë me origjinë shqiptare nga Shkupi. Ai u lind në Shkup në shtatorin e vitit 1883. Mbaroi shkollën qytetare në Selanik e më tej Gjymnazin ushtarak në Manastir me rezultate të shkëlqyera dhe ndoqi Shkollën e lartë ushtarake në Stamboll, ku gjithashtu bëri emër të mirë dhe u dallua ndër të tjerët. Në vitin 19, përfundoi studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Stambollit në të njëjtën kohë me Qemal Ataturkun, të cilin e kishte pasur shok klase qysh në kohën që vazhdonin mësimet në Selanik. Në përfundim të kësaj Akademie fitoi gradën kapiten Shtatmadhorie.

tjetër. Prandaj, Mehmet pashë Deralla dhe kryetari i parë i këtij shteti të posakrijuar nxituan të krijonin këto forca që do të ishin mburojë e pavarësisë, e tërësisë së saj tokësore dhe e rendit të saj të prishur.

Në këto rethana tepër të rënda, Ismail Qemali i mbështetur fuqishëm nga ministri i Luftës Deralla dhe më pas edhe nga shefi i Shtabit Madhor Shqiptar, major Ali Shefqeti (Shkupi), si dhe afro 70 oficerë e 150 nën-oficerë të tjerë gjithashtu shqiptarë të shkolluar dhe me detyra në ushtrinë osmane. Ndër ta ishin edhe Mustafa Maksuti, Mustafa Aranitasi, Rexhep Shala, Ismail H. Tatzati, të ardhur enkas për të ofruar ndihmesën dhe shërbimin e tyre të vyer në ngritjen e ushtrisë dhe të strukturave të tjera të forcave të armatosura të shtetit të pavarur shqiptar.<sup>30</sup>

Për ardhjen e këtyre ushtarakëve jo vetëm të aftë, por edhe atdhetarë të vërtetë, një rol të veçantë kishte luajtur vetë Ismail Qemali me veprën dhe me emrin që gëzonte ndër shqiptarët dhe në tërë hapësirën e Perandorisë Osmane. Kështu, hap pas hapi këta ushtarkë të përkushtuar arritën të formonin një forcë prej 12 mijë vetash të ndarë në 14 batalione të ushtrisë me nga 400-500 njerëz secili, si dhe një trup xhandarmërie me 4.000-5.000 veta të ndarë në 4 detashmente.<sup>31</sup>

Në krye të piramidës ushtarake shqiptare qëndronte Ministria e Luftës në krye me Mehmet Pashë Derallën, që kryente edhe detyrat e komandës së përgjithshme. Më pastaj vinte Shtabi Madhor me zyrat dhe shërbimet më të nevojshme. Organizimi pasoi menjëherë edhe nëpër prefektura, nënprefektura, komuna dhe fshatra të gërshtuara me organizimin e ushtrisë së rregullt. Kështu plotësohej skema organizative e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Të gjitha këto formacione ushtarake krahas detyrave të tjera organizative në përputhje me urdhëresat qeveritare duhej të luftonin për të mbrojtur vendin dhe shtetin nga pushtimi, si dhe të ruanin rendin e qetësinë.

Në periudhën afro dyvjeçare brenda së cilës u krijua dhe veprroi Ushtria Shqiptare së bashku me xhandarmërinë, nën përkujdesjen e Ismail Qemalit në cilësinë e kryetarit të Qeverisë së parë shqiptare, drejtuesit kryesorë ushtarakë të saj Mehmet Deralla dhe Ali Shefqeti, në kushte shumë të vështira arritën të krijonin e të organizonin strukturat kryesore ushtarake dhe të përballëshin edhe me detyrat luftarake mbrojtëse në veri dhe në jug të vendit.<sup>32</sup> Në themelet e organizimit të ushtrisë dhe të

<sup>30</sup> Gjergj P. Titani, Proletar Hasani, *Personalitete ushtarake në vite*.

<sup>31</sup> Libri "*Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*", Tiranë, 1963.

<sup>32</sup> Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike VIII-1978, f. 229-230.

<sup>33</sup> Bardhosh Gaçe, vep. e cituar f. 53.

forcave të armatosura shqiptare burrat dhe ushtarakët e pavarësisë vunë atdhetarizmin, përkushtimin dhe aftësitë e tyre.

Në themelet e hedhura me aq zell e përkushtim, me aq vështirësi, në dhjetorin e vitit 1912 nga Qeveria dhe ushtarakët e parë të shquar shqiptarë, zuri fill ushtria shqiptare, ajo që më pas do të rritej dhe në të cilën i ka rrënjët ushtria shqiptare pasardhëse. Nga kjo ushtri do të dilnin ushtarakë të përkushtuar, të aftë e të shkolluar që do ta shtrinin veprimtarinë e tyre nga njëra periudhë historike tek tjetra, në atë të luftës antifashiste nacionalçlirimtare dhe në vitet që pasuan pas çlirimit të vendit në interes të popullit dhe të Shqipërisë.

Forcat shqiptare u organizuan edhe me ndihmën e 150 oficerëve holandezë, në krye me të mirënjohurin De Veer, që u morën me organizimin dhe stërvitjen për herë të parë të xhandarmërisë shqiptare sipas parimeve moderne perëndimore. Deralla, ndonëse me shkollim ushtarak lindor, parapëlqente gërshetimin e saj me përvojën e shkollimeve ushtarake perëndimore. Ministri i Luftës me një koncept të qartë teorik mendoi të sanksiononte me rregullore mënyrën e organizimit dhe të veprimtarisë së Forcave të Armatosura Shqiptare, që të kishin një rrjedhë të përcaktuar e jo fiktive, që të stërviteshin dhe të luftonin njëherësh. Këtë e dëshmojnë disa rregullore të asaj kohe që kanë arritur deri në ditët tona.

Deri para pak vitesh gjeneral Mehmet Deralla njihej vetëm si një emër dhe asgjë më shumë, por më që pluhuri i harresës së viteve të shkuara nisi të shkundet ai vjen midis nesh më i afërt, më i plotë, më i dashur dhe i fiksuar plotësisht në kujtesën e popullit. Përvoja ushtarake e Derallës gjeti shprehje edhe në hartimin e “Rregullores për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës” 13 prill 1913, dhe “Rregulloren e Qeverisë së përkohshme mbi formimin e Milicisë Shqiptare” më 13 qershor 1913.<sup>33</sup>

Mehmet pashë Deralla qëndroi në detyrën e ministrit të Luftës nga 4 dhjetori 1912 deri më 20 maj 1914.<sup>34</sup> Gjatë kësaj kohe, përkrah Ismail Qemalit u shfaq personaliteti i gjeneral Derallës si një ushtarak i shquar erudit dhe i pjekur, i kalitur në shkollën e kryengritjeve dhe i pajisur me një kulturë të plotë ushtarake.

<sup>34</sup> Z. Idrizi, *Mehmet Pashë Deralla- ministër i parë i Ushtrisë Shqiptare*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike, 28-29, Prishtinë, 2002, f. 178; “Rilindja” 25 nëntor 1992; “Flaka” 25 maj 1997.

*Dr. Zeqirja Idrizi*

THE ROLE OF MEHMET PASHA DERALLA IN THE DECLARATION  
OF INDEPENDENCE

**Summary**

One of the most distinguished personalities of the Albanian people of Pollog at the first half of the 19<sup>th</sup> century and first decades of the 20<sup>th</sup> century was General Mehmet Pasha Deralla. He took his first education at his birthplace, continuing with the middle education in Shkup and Military Academy at Istanbul where he obtained the grade of the general. He was member of the Albanian Leagues of Prizren and Peja. During 1910-1911 and 1912 he was involved in the uprising that took place in the Albanian lands. He was Minister of War in the Vlora Government.